



Nr. 2 prot
dt. 28/02/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

VENDIM

Nr. 1, datë 23.02.2023

PËR

SAKTËSIMIN E KOORDINATAVE DHE MIRATIMIN E
RINOVIMIT TË LEJES ME NR.82/6 PROT., DATË 06.02.2018,
TË SUBJEKTIT “ARBËR SHERO”.

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

V E N D O S I:

1. Saktësimin e koordinatës X të vendndodhjes së pus-shpimit të lejes me Nr.82/6 prot., datë 06.02.2018, miratuar me vendimin nr.10, datë 24.01.2018 nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë si më poshtë:

a) Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit do të saktësohen:

Nga:

- X = 4440734; Y = 4530275; Z = 704 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

- X = 524860.4; Y = 4530289.6; Z = 704 m.m.n.d. (KRGJSH)

Në:

- X = 4470734; Y = 4530275; Z = 704 m.m.n.d. (Gauss Kruger)

- X = 554858; Y = 4530290; Z = 704 m.m.n.d. (KRGJSH)

2. Miratimin e rinovimit të lejes me koordinatën X të vendndodhjes së pusshpimit të saktësuar si më sipër, për përdorim burimi ujqor nëntokësor për qëllime sanitare me Nr.82/6 prot., datë 06.02.2018, miratuar nga KBU Drinë-Bunë me vendimin Nr.10, datë 24.01. të subjektit “Arbër Shero”, me vendndodhje: Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e pus-shpimit (KRGJSH):

- X = 554858; Y = 4530290; Z = 704 m.m.n.d.

Sasia e ujqit që jepet për përdorim: Q=0.2 l/sek

Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH):

- X = 554871; Y = 4530282; Z = 703.3 m.m.n.d.

Vendi i shkarkimit të ujqërave të përdorura: Në rrjetin e kanalizimeve të ujqërave të përdorura të qytetit.

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

